



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**  
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Kuvendi i  
Komunës

01Nr. \_\_\_\_\_ 2011  
Datë . 16.03 . 2011

### PROJEKT / DRAFT

Në bazë të nenit 40 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 25 pika(1) të Statutit të Komunës së Deçanit dhe Ligjit për Mbeturina Ligji Nr. 02/L-30, Kuvendi Komunal i Deçanit në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_ nxjerrë këtë

## **RREGULLORE**

### **PËR MENAGJIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E DEÇANIT**

#### **PËRKUFIZIMET**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore nënkuptojnë

**Mbeturinë – nënkupton çdo** substancë ose lëndë e specifikuar si mbeturinë Komunale , Komeriale dhe mbeturinë Inerte

**Menaxhim i mbeturinave** – nënkupton , mbledhjen , grumbullimin, transportimin trajtimin e mbeturinave dhe deponimin e tyre

**Mbeturinë Komunale** – janë mbeturina nga amvisëritë dhe aktivitetet tjera të ngjashme të cilat në përbërjen e tyre nuk janë të klasifikuara si mbeturina speciale, industriale dhe të rrezikshme.

**Mbeturinë komerciale** – nënkupton mbeturinat që krijohen për shkak të aktiviteteve të bizneseve për qëllime të funksionimit të tregut dhe zejeve .

**Mbeturina inerte-** janë mbeturina që nuk pësojnë ndryshime të rrezikshme kimike fizike apo biologjike

**Prodhues i mbeturinave** – konsiderohen personat juridik dhe fizik të cilët për shkak të aktiviteteve të tyre prodhojnë mbeturina

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim:

- 1.1. Pastrimin e vendeve të ndotura nga mbeturinat dhe administrimin e mbeturinave në territorin e komunës
- 1.2. Zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe zvogëlimi ose ndalimi i atyre aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera që përbëjnë në rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- 1.3. Mbrojtja e balancit të përgjithshëm ekologjik në territorin e Komunës;
- 1.4. Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës bujqësore;
- 1.5. Mbrojtja e pamjeve të vlefshme natyrore.
- 1.6. Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit.
- 1.7. Mënjanimin e aromave të dëmshme dhe kundërmimeve parazitëve dhe bezdisjeve tjera.

### Neni 2

Kjo rregullore trajton mbeturinat komunale dhe komerciale ,mbledhjen, grumbullimin, transportimin nga vendi i prodhimit të mbeturinave deri në deponin e mbeturinave.

### Neni 3

Administrimi i mbeturinave ,trajtimi, mbledhja , grumbullimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave do të bëhet nga Ndërmarrja Komunale “Higjiena” apo ndonjë ndërmarrje tjetër e licencuar.

### **Neni 4** **Detyrimet**

Personat juridik dhe fizik që konsiderohen prodhues të mbeturinave kanë këto detyrime

#### Bizneset

- 4.1. Bizneset të cilat afarojnë në komunën e Deçanit kanë për obligim që individualisht të posedojnë kontonjeret ku i hedhin mbeturinat.
- 4.2. Kontonjeret apo shportat duhet të jenë të vendosura brenda lokaleve ,në pjesën e përparme ose të pasme të lokalit.
- 4.3. Vendosja e kontonjerve duhet të bëhet me lejen e organit kompetent komunal Drejtoratit për Sherbime Publike, që mos të ndikoj negativisht në dukjen e qytetit dhe të bëhen pengesë për kalimtarë,
- 4.4. Bizneset të cilat aktivitet e tyre i ushtrojnë në zonën urbane duhet që së paku një herë në muaj të dëshmojnë para organeve kompetente komunale faturën e pagesës për shërbimet e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave.

4.5. çmimi i shërbimeve të ofruara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërmarrja komunale “Higjena” do të përcaktohet në bazë të kontratës marveshjes në mes palëve kontraktuese dhe në përputhje me tarifat e caktuara me vendim të Kuvendit Komunal.

## Neni 5 Ekonomitë familjare

- 5.1. Janë të obliguara që të kenë kontonjerët individual ose të përbashkët varësisht nga natyra e organizimit të tyre
- 5.2. Ndërtesat kolektive ku ka shumë njësi banuese (banesa) mundë të kenë një kontonjer të përbashkët
- 5.3. Lagjet mund të kenë po ashtu sipas marveshjes së organizimit kontonjer të përbashkët
- 5.4. Ekonomitë familjare mund të kenë kontonjer të veçantë të vendosur brenda oborreve të tyre.
- 5.5. Çmimet për shërbimet e ofruara të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave do të përcaktohen në bazë të kontratës .
- 5.6. Kontonjerët duhet të jenë të vendosur në vendet e përcaktuara nga organi kompetent komunal ( Drejtorati i shërbimeve Publike).

## Neni 6 Institucionet

- 6.6. Të gjitha institucionet , Arsimore ,Kulturore, Shëndetësore Fetare, Ndërtesat Komunale dhe Qeveritare janë të obliguara që të pajisen me kontonjer ,
- 6.7. Kontonjerët duhet të jenë të vendosur në vendet ku është e mundur qasja sa më e lehtë për shërbimin e transportit të mbeturinave.

## Neni 7 Obligimet e Ndërmarrjes

- 7.1. Hartimin e planit vjetor për menaxhimin e mbeturinave
- 7.2 .azhurnimin e planit vjetor dhe rishqyrtimin e tij në periudha të përcaktuara me ligjin mbi mbeturinat.
- 7.3. zhvillimin e kapaciteteve për futjen në sistem për grumbullimin mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave deri në deponi për krejt vendbanimet e komunës
- 7.4. lidhjen e kontratave individuale me prodhuesit e mbeturinave
- 7.5. grumbullimin dhe mbledhjen e mbeturinave sipas marveshjes nën kushtet kontraktuese
- 7.6. transportimin e mbeturinave në deponin e përcaktuar
- 7.7. mbledhjen e mbeturinave në baza ditore në vendbanimin urban në afate kohore të përcaktuara gjatë ditës (p. sh ora 6:00 ose ora 19:00)
- 7.8. në vendbanimet rurale mbledhje e mbeturinave bëhet çdo 15 ditë apo dy herë në muaj

7.9. është përgjegjës për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme , speciale dhe lojeve të tjera të mbeturinave të cilat për shkak të veçorive të tyre paraqesin rrezik për shëndetin dhe mjedisin në përgjithësi.

#### Neni 8

Tarifat për shërbimet e ofruara nga Ndërmarrja që administron me mbeturinat miratohen në Kuvendin Komunal,.

#### Neni 9

Lartësia e tarifave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave vendoset sipas kategorisë dhe mënyrës së ofrimit të shërbimit.

- a) Kategoria e konsumatorëve shtëpiak deri në 4 € në muaj
- b) Kategoria e konsumatorëve komercial, nënkategoria veprimtaritë e vogla zejtare shërbyese deri në 5 € në muaj.
- c) Kategoria e konsumatorëve komercial, nënkategoria veprimtaritë e vogla dhe të mesme komerciale deri në 10 € në muaj.
- d) Kategoria e konsumatorëve komercial, nënkategoria veprimtaritë e mesme të mëdha komerciale ,shërbyese dhe prodhuese deri në 20 € në muaj.
- e) Kategoria e konsumatorëve institucional deri në 5 € në muaj.

#### Neni 10

##### Të drejtat e Operatorit

9.1. Ndermarrja ka të drejtë të bëjë trajtimin e mbeturinave që nënkupton ndarjen e mbeturinave në lloje , më qellim të pakësimit të karakteristikave të dëmshme

9.2. Të bëjë ndërmjetimin të organizoj shitjen, mbledhjen përpunimin dhe deponimin e mbeturinave.

9.3. Të vendosë në vende të caktuara kontonjerët për ndarjen e mbeturinave ,shpenzimet për vendosjen dhe administrimin e këtyre kontonjerve e bartë vetë ndërmarrja

#### Neni 11

10.1 .Ndërmarrja komunale “Higjiena” harton planin lokal për administrimin e mbeturinave,plan i cili duhet të jetë në harmoni me planin strategjik të Kosovës për administrimin e mbeturinave dhe i miratuar nga Kuvendi Komunal.

10.2. Të bëjë planprogramin për grumbullimin e mbeturinave të komunalive nga amvisëritë dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme nga mbeturinat komunale respektivisht nga amvisëritë.

10.3. Të hartoj programet për vetëdijesimin e publikut lidhur me administrimin e mbeturinave.

#### Neni 12

Ndërmarrja komunale higjiena për aktivitetet që ushtron do të financohet nga:

- a) Vetëfinancimi në emër të aktiviteteve që ushtron ndërmarrja.
- b) Nga buxheti Komunal
- c) Buxheti i qeverisë së Kosovës dhe
- d) Donatorët

#### Neni 13

13.1. Ndërmarrja Komunale Higjiena për aktivitet e veta i përgjigjet Kuvendit Komunal të Deçanit nëpërmes bordit mbikqyrës .

13.2. Komuna mundë të bëjë marrëveshje me dy apo me shumë komuna për administrimin e mbeturinave në territorin e tyre

#### Neni 14

14.1. Inspektimin e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave e bënë Inspektori Komunal për Mbrojtje të Mjedisit.

14.2. Autorizimet inspektori komunal i ushtron në përputhje me autorizimet ligjore administrative.

#### Neni 15

##### MASAT NDËSHKIMORE

15.1. Masave ndëshkimore ju nënshtrohen të gjithë prodhuesit e mbeturinave dhe ndërmarrja që bënë administrimin e mbeturinave.

15.2. Të gjithë prodhuesit e mbeturinave të cilët bëjnë hedhjen e tyre në vende që s'janë të destinuara për këtë qëllim do të dënohen me gjobë.

15.3. Me gjobë nga 10 deri 50 euro ndëshkohen kategoritë e ekonomive familjare.

15.4. Me gjobë nga 50 deri 200 ndëshkohen kategoritë komerciale.

15.5. Me gjobë nga 50 deri 500 ndëshkohen kategoritë institucionale.

15.6. me gjobë nga 500 deri 1000 ndëshkohet kompania komunale në rastet e hedhjes së mbeturinave në vendet që s'janë të destinuara si deponi.

## Dispozitat Përfundimtare

### Neni 16

Për çështjet që s'janë të rregulluara apo bien ndesh me dispozitat e kësaj rregullore komunale, vlejnë dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe Udhëzimeve Administrative që trajtojnë këtë aspekt.

### Neni 17

Kjo rregullore hynë në fuqi tetë ditë nga miratimi i saj në Kuvendin Komunal

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Jashar DOBRAJ